Kronikë

Goditet grupi kriminal i trafikut të armëve dhe kultivimit të drogës në Fier, 4 në pranga! Sekuestrohen 6 armë zjarri, kanabis, radio e uniforma policie (VIDEO+EMRAT)

Grupi vepronte në disa qytete për trafikun e armëve. Të arrestuarit janë me rrezikshmëri shoqërore dhe me precedentë penalë. U sekuestruan 6 armë zjarri, municion luftarak, mijëra fidanë dhe fara kanabisi.

■ Armë, municion, maska dhe drogë mes ullinjve! Dalin pamjet nga operacioni që çoi në goditjen e grupit kriminal në Fier

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Qendërsoftu

[Sh.COM] Redaksia
3 Qershor, 10:05 | Përditësimi: 3 Qershor, 12:09

Share

A A

Një grup kriminal që trafikonte armë zjarri dhe merrej me kultivimin dhe shitjen e lëndëve narkotike është goditur në Fier nga Policia Vendore në bashkëpunim me Prokurorinë në kuadër të operacionit "Procedimi".

Në pranga kanë rënë 4 persona, me precedentë penalë dhe rrezikshmëri shoqërore, Boran Buzi, Niko Osma, Qamil Shurdhi dhe Besim Buzi. Të arrestuarit janë Boran Buzi 48-vjeç, Qamil Shurdhi 48-vjeç, të cilët vepronin si organizatorët e grupit, ndërsa Niko Osma 53-vjeç dhe Besim Buzi 33-vjeç, siguronin armët dhe klientët. Ndërkohë një tjetër 51-vjeçar u procedua në gjendje të lirë.

Në banesën e Niko Osman në Durrës, u gjet edhe një pistoletë, të cilën tentoi ta hidhte nga dritarja në momentin e ndërhyrjes së policisë. Në kuadër të operacionit u sekuestruan 6 armë zjarri e gjahu, 4 mijë fidanë kanabisi, 5 mijë fara kanabisi, qindra fishekë të kalibrave të ndryshëm, radio dhe uniforma policia.
Nga hetimet rezultoi se këta persona kryenin trafikun e armëve dhe municionesve si dhe mbanin armë zjarri për qëllime kriminale. Aktivitetin e kryenin në disa qytete si Fier, Lushnje, Durrës, Shkodër dhe Kukës. Në disa raste, armët i siguronin edhe nga Kosova dhe i fusnin ilegalisht përmes kufirit të gjelbër në pikën kufitare të Morinës.

[Sh.COM]

LEXO EDHE:
Sërish zjarr në pyllin e Darëzezës, 7 mjete zjarrfikëse punuan në terren! 10 ha në flakë, ndërhyrje edhe nga ajri me helikopterin 'Cougar'

Nga hetimet, u zbulua gjithashtu se grupi merrej edhe me kultivimin dhe shitjen e kanabisit. Gjatë operacionit u ushtruan kontrolle në 8 banesa, dy ambiente të dyshuara për magazinimin e armëve dhe municionit luftarak si dhe në tre automjete.

Procedimi u iniciua nga Sektori për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve të Paligjshme në DVP Fier dhe u ndoq në bashkëpunim me Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale të Policisë së Shtetit.

Të arrestuarit
Boran Buzi, 48 vjeç, banues në Kalfm, Fier, i dënuar më parë në Itali, me 30 vjet burgim, për veprat penale "Shfrytëzimi i prostitucionit" dhe "Arrëmbatja pa leje";
Niko Osma, 53 vjeç, banues në Durrës, me precedent penal në fushën e arrëmbatjes pa leje;
Qamil Shurdhi, 48 vjeç, banues në Lushnjë, i dënuar më parë për veprimtari kriminale në fushën e narkotikëve dhe të arrëmbatjes pa leje;
Besim Buzi, 33 vjeç, banues në Divjakë.

U sekuestruan
4000 fidanë kanabisi (3000 të mbjella dhe 2000 të kultivuar në kubikë);
3 armë zjarri automatike, 2 armë gjahu dhe 636 fishekë të kalibrave të ndryshëm;
5000 fara kanabisi;
2 radio si të Policisë, 2 uniforma policie, 1 maskë plastike me paruke;
3 automjete dhe 10 celularë.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:54
Armë, municion, maska dhe drogë mes ullinjve! Dalin pamjet nga operacioni që çoi në goditjen e grupit kriminal në Fier

Dalin pamjet e operacionit të koduar "Procedimi" që çoi në goditjen e një grupi kriminal që merrej me trafik armësh dhe kultivim droge në Fier.

Në pranga u vunë 4 persona, dy prej të cilëve vepronin si organizatorë, ndërsa dy të tjerët siguronin armët e zjarrit dhe klientët. U ushtruan kontrolle në banesa dhe magazinea, ndërsa u sekuestruan 6 armë zjarri, municion luftarak, bimë dhe fidanë kanabisi, maskë plastike dhe uniforma policie.

Në pamje shihet edhe kanabisi i mbjellë mes ullinjve për të 'humbur' gjurmët.

Xh.D/Shqiptarja.com

Share

Xh.D/Shqiptarja.com

TAG: grup kriminal Fier Boran Buzi Qamil Shurdhi Niko Osma Besim Buzi

Komento

Komente

Ndalohet riprodhimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Cilat duhet të jenë prioritetet e mandatit të katërt të qeverisë Rama?

2 Qershor, 09:06

Integrimi në BE | Luftë korrupsionit | Rritja ekonomike

Lajme të tjera

Dhjetëra vullnetarë në mbrojtje të natyrës, zona e 'Pishë Poro' në Darzezë pastrohet nga mbetjet

Kristaq Thano

1 Qershor, 16:10

Digjet pylli me pisha në Darëzezë, flakët drejt shuarjes! 50 forca zjarrfikëse punuan në terren (VIDEO)

1 Qershor, 15:06

'Pleqëri me kusure' shfaqet premiereë në Teatrin e Bylisit, me finesë përcillen mesazhe të forta për të moshuarit

31 Maj, 18:34

Qytetet bregdetare dhe liqenore 'hapin dyert' për turistët! Sezoni starton me koncerte, panaire dhe sporte ujore

31 Maj, 15:51

Fier/ Shpërthen në flakë automjeti në aksin Fier-Roskovec, shpëtojnë mrekullisht shoferi

31 Maj, 14:04

Darëzeza çel sezonin turistik 2025, aktiviteti 'Festa e Valëve' mbledh bashkë dhjetëra pjesëmarrës

Kristaq Thano

31 Maj, 11:27

Historia e rrallë e motorit të Luftës së Dytë Botërore, Ferman Bendaj: Babai e la amanet ta ruajmë! E bleu me kile dhe e restaurol! Sot krenari e familjes

Marsela Topi

31 Maj, 10:44

Mbyllet me mesnatë aplikimi për subvencionet ne bujqësi! Mbi 90 për qind e fermerëve kërkojnë naftën pa akcizë

Vjet Salasi

Armand Braho

30 Maj, 15:38

Fier/ Çiklisti rrëzohet pranë vijës së finishit, malazezi Jovan Divnic fiton etapën e fundit në Rrethin e Shqipërisë! Tom Jokmans shpallet kampion (VIDEO)

30 Maj, 12:31

Fier/ Asgjësohen 1000 fidanë kanabisi në Libofshë, në pranga 63-vjeçari (EMRI+VIDEO)

30 Maj, 10:59

Aksident në Divjakë, 18-vjeçari përplas për vdekje të moshuarin (VIDEO)

30 Maj, 09:20

Turi i 82-të çiklistik i Shqipërisë! Sot etapa e pestë dhe e fundit, aksi Fier-Savër i bllokuar nga ora 10:50 deri në 12:00

30 Maj, 08:51

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kësaj faqeje